



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2024, mori këtë;

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokalet Afariste në Tregun e Qytetit

Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës sipas vendimit nr.prot.01-947/03-0015807/24 të datës 04 mars 2024 për miratim paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës – Lokalet afariste në Tregun e Qytetit (Lokalet afariste me numra rendor: nr.7 me sipërfaqe 40.72 m²; nr.8 me sipërfaqe 28.17 m²; nr.21 me sipërfaqe 28.17 m²; nr.22 me sipërfaqe 28.17 m²; nr.36 me sipërfaqe 15.37 m²; nr.52 me sipërfaqe 15.37 m²; nr.53 me sipërfaqe 15.37 m²; nr.54 me sipërfaqe 15.37 m²), të ndërtuara në Njësinë kadastrale P-00244-1 dhe evidentuara në Certifikatën pronësore nr.08-942/06-0012196/24 të datës 20.02.2024, Kopjen e Planit dhe dokumentacionin tjetër bashkëngjitur këtij vendimi, me destinim sipas Hartës Zonale-Zonë Ndërtimore, Zona Kadastrale Podujevë, në këtë përbërje:

1. **z.Valon Demolli**, nga Kuvendi i Komunës
2. **z.Haki Rudari**, nga Kuvendi i Komunës
3. **z.Bahri Selimi**, nga Ekzekutivi i Komunës
4. **znj.Xhevrie Beqiri**, nga Ekzekutivi i Komunës
5. **znj.Fahrie Rashiti**, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit nr.prot.01-947/03-0015807/24 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës 04 mars 2024.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0015814/24
Podujevë, datë, 04 mars 2024

